



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i dosjes: KSC-BC-2020-07
Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 17 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidenciale

Parashtrimet e Prokurorisë mbi procedurën e rishikimit të Aktakuzës

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit për Hysni Gucatin

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtësit kujdestar për Nasim

Haradinajn

Bastian Martens

I. HYRJE

1. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhet të lejojë nxjerrjen e Aktakuzës¹ për Mbrojtjen, ose nuk duhet të lejojë Mbrojtjen që të bëjë parashtrime në lidhje me Aktakuzën në fazën e tanishme të procesit.² Kjo do të ishte e papajtueshme me Ligjin³ dhe Rregulloren.⁴ Nuk ka faktorë që përlligjin shmangien nga korniza ligjore në fuqi. Veçanërisht, paraburgimi i z. GUCATI dhe z. HARADINAJ (bashkërisht, 'të dyshuarit') bazohet në vendimin për arrestim⁵ dhe fletarrestimet,⁶ kopjet e të cilave u janë dhënë atyre. Rrjedhimisht, përmbajtja konkrete e Aktakuzës nuk është e domosdoshme, madje as relevante për rishikimin efektiv të paraburgimit të tyre. Për më tepër, nxjerrja e Aktakuzës për Mbrojtjen mund të ndikojë negativisht në integritetin e provave dhe mund të dëmtojë hetimet aktuale të ZPS-së.

2. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithsesi vendos të lejojë nxjerrjen e Aktakuzës për Mbrojtjen në këtë fazë të procesit; (i) paraqitja e fakteve duhet të redaktohet; dhe (ii) Mbrojtja nuk duhet të lejohet të bëjë parashtrime në lidhje me Aktakuzën gjatë rishikimit të saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Një qasje e tillë do ta informonte Mbrojtjen për veprat penale dhe format e përgjegjësisë penale konkrete, të pretenduara në Aktakuzë, duke siguruar njëkohësisht kryerjen e shpejtë të procesit e jo bllokimin e tij prej kontestimeve juridike të panevojshme dhe të parakohshme.

¹ Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesa të lidhura me të, KSC-BC-2020-07/F00063/A01, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, 30 tetor 2020 ('Aktakuza').

² *Shih* Urdhër për parashtrime mbi procedurën e rishikimit të Aktakuzës, KSC-BC-2020-07/F00065, 11 nëntor 2020 ('Urdhri'), para. 13(a).

³ Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'). Të gjitha referencat në lidhje me 'neni' ose 'nenet' këtu u referohen neneve të Ligjit, përveç nëse është saktësuar ndryshe.

⁴ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Të gjitha referencat në lidhje me 'rregulla' ose 'rregullat' këtu i referohen Rregullores, përveç nëse është saktësuar ndryshe.

⁵ Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra për transferim, KSC-BC-2020-07/F00012, publik, 24 shtator 2020 ('Vendimi i arrestimit').

⁶ Fletarrestim për Hysni Gucatin, KSC-BC-2020-07/F00012/A01, konfidencial dhe *ex parte*, 24 shtator 2020; Versioni i korrigjuar i fletarrestimit për Nasim Haradinajn, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR, konfidencial dhe *ex parte*, 24 shtator 2020 (bashkërisht 'fletarrestimet').

II. RRETHANAT DHE HISTORIKU PROCEDURAL

3. Më 24 shtator 2020, në përputhje me kërkesën e ZPS-së,⁷ Gjykatësi i Vetëm konstatoi se ekziston dyshimi i bazuar se të dyshuarit: (i) kishin tentuar kryerjen e veprës penale të frikësimit, sipas nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, nr. 06/L-074 ("KPK"); (ii) kishin kryer veprën penale të hakmarrjes, sipas nenit 388 të KPK-së; dhe (iii) kishin kryer veprën penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës, sipas nenit 392 të KPK-së.⁸ Gjykatësi i Vetëm gjithashtu konstatoi se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston rreziku që të dyshuarit mund të arratisen, të pengojnë kryerjen e procedurave, ose të kryejnë vepra penale të tjera, duke e bërë kështu të domosdoshëm arrestimin dhe paraburgimin e tyre, në pajtim me nenin 41(6)(b) të Ligjit, dhe miratoi kërkesën për arrestimin dhe transferimin e tyre.⁹

4. Më 25 shtator 2020, të dyshuarit u arrestuan.¹⁰

5. Më 29 shtator dhe 1 tetor 2020, z. HARADINAJ¹¹ dhe z. GUCATI¹² bënë paraqitjet e para përkatëse, gjatë të cilave u informuan, ndër të tjera, për: (i) konstatimin prej Gjykatësit të Vetëm të dyshimit të bazuar se kishin kryer, ose kishin tentuar të kryenin veprat penale të frikësimit, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës; dhe (ii) arsyet pse Gjykatësi i Vetëm konstatoi se ekzistonin arsye të artikulueshme për të besuar se arrestimi i tyre ishte i domosdoshëm. Të dy të dyshuarit konfirmuan se ishin informuar më herët për arsyet e arrestimit të tyre.¹³

⁷ Kërkesë urgjente për fletarrestime dhe urdhra të lidhura me to, KSC-BC-2020-07/F00009, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, 22 shtator 2020. Versioni konfidencial dhe i redaktuar i kësaj kërkesë, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED, u protokollua më 1 tetor 2020 ('Kërkesa e ZPS-së'). Në këtë version nuk është redaktuar asnjë informacion thelbësor.

⁸ Vendimi i arrestimit, SC-BC-2020-07/F00012, paragrafët 22, 24, 26.

⁹ Vendimi i arrestimit, KSC-BC-2020-07/F00012, paragrafët 28-31, 36.

¹⁰ Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4), KSC-BC-2020-07/F00015, publik, 25 shtator 2020; Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4), KSC-BC-2020-07/F00016, publik, 25 shtator 2020.

¹¹ KSC-BC-2020-07, Transkript, publik, 29 shtator 2020, faqet 4, 6-9.

¹² KSC-BC-2020-07, Transkript, publik, 1 tetor 2020, faqet 6-11.

¹³ KSC-BC-2020-07, Transkript, publik, 29 shtator 2020, f. 6; KSC-BC-2020-07, Transkript, publik, 1 tetor 2020, f. 11.

6. Më 27 tetor 2020, Gjykatësi i Vetëm hodhi poshtë kërkesën e z. HARADINAJ për lirim të menjëhershëm, duke konstatuar, ndër të tjera, se ende ekzistonte rreziku i arratisjes së zotit HARADINAJ dhe gjithashtu rreziku që ai mund të pengonte kryerjen e procedurave dhe rreziku se mund të kryente vepra penale të tjera.¹⁴

7. Në të njëjtën ditë, Gjykatësi i Vetëm hodhi poshtë kërkesën e z. GUCATI për dorëzani, duke konstatuar, ndër të tjera, se: (i) krahas faktorëve të përmendur në vendimin për arrestim, njoftimi për fletarrestim dhe angazhimi i ZPS-së për të paraqitur aktakuzë e shton motivimin e z. GUCATI për t'u arratisur; dhe (ii) fakti që aktakuza nuk ishte paraqitur, nuk e vinte në dyshim vlerësimin e Gjykatësit të Vetëm se arrestimi dhe paraburgimi ishin të domosdoshëm duke pasur parasysh rrezikun e pengimit të procedurave dhe rrezikun e kryerjes së veprave penale të tjera prej z. GUCATI dhe nuk e bënte të paarsyeshëm ose të tepruar vazhdimin e paraburgimit në këto rrethana.¹⁵

8. Më 30 tetor 2020, ZPS-ja paraqiti Aktakuzën. Aktakuza u klasifikua si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* në pajtim me rregullat 85(4) dhe 86(2). Së bashku me Aktakuzën u parashtrua edhe një kërkesë e arsyetuar për mosnxjerrjen e përkohshme të Aktakuzës dhe dokumenteve lidhur me të dyshuarit.¹⁶

9. Më 11 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi urdhrin përmes të cilit informonte të dyshuarit për paraqitjen e Aktakuzës dhe kërkonte parashtrime mbi mundësinë e nxjerrjes së Aktakuzës për Mbrojtjen, me redaktimet e nevojshme, dhe mbi mundësinë e lejimit të Mbrojtjes për paraqitjen e parashtrimeve lidhur me Aktakuzën gjatë kohës së rishikimit të saj prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹⁷

¹⁴ Vendim në lidhje me kërkesën për lirim të menjëhershëm të Nasim Haradinajt, KSC-BC-2020-07/F00058, publik, 27 tetor 2020, paragrafët 21, 24, 26 ('Vendim në lidhje me kërkesën e Haradinajt për lirim').

¹⁵ Vendim në lidhje me kërkesën për dorëzani, KSC-BC-2020-07/F00059, publik, 27 tetor 2020, para 14, 24 ('Vendimi për dorëzani për Gucatin').

¹⁶ Parashtrimi i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesat e lidhura me të, KSC-BC-2020-07/F00063, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, 30 tetor 2020, para 5-6 ('Parashtrimi shoqëruar i Aktakuzës').

¹⁷ Urdhri, KSC-BC-2020-07/F00065, paragrafët 5, 13.

III. PARASHTRIMET

A. AKTAKUZA NUK DUHET T'I BËHET E DITUR MBROJTJES

(i) *Do të ishte e papajtueshme me Ligjin dhe Rregulloren që Aktakuza t'i bëhet e ditur Mbrojtjes*

10. Sipas Ligjit dhe Rregullores, Mbrojtja nuk e gëzon të drejtën që të marrë aktakuzën ose të bëjë parashtrime në lidhje me të, përveçse pas konfirmimit të aktakuzës.¹⁸ Rregullorja parasheh shprehimisht se, para konfirmimit të aktakuzës, të gjitha dokumentet dhe informacioni i dorëzuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake nga ZPS-ja gjatë hetimeve mbeten më së paku konfidenciale dhe *ex parte*,¹⁹ dhe se ZPS-ja ia paraqet Gjykatësit të Procedurës Paraprake aktakuzën në mënyrë konfidenciale dhe *ex parte*.²⁰

11. Megjithëse Ligji dhe Rregullorja parashikojnë mundësinë e urdhërimit të arrestimit dhe paraburgimit para konfirmimit të aktakuzës,²¹ nuk është përcaktuar asnjë praktikë alternative për procedurën e konfirmimit. Dispozitat lidhur me parashtrimin, shpërndarjen dhe konfirmimin *ex parte* të aktakuzës, dhe të kontestimeve juridike në lidhje me to, vlejnë pavarësisht nga fakti nëse të dyshuarit janë tashmë në paraburgim.

12. Rrjedhimisht, nuk do të ishte në pajtueshmëri me Ligjin dhe Rregulloren që, në këtë fazë të procesit Aktakuza²² t'i bëhet e ditur Mbrojtjes dhe të lejohen parashtrimet në lidhje me të. Nuk ekzistojnë arsye unike, të paparashikuara, apo arsye të tjera bindëse për t'u shmangur nga formulimi i qartë dhe qëllimet e kornizës ligjore në fuqi,

¹⁸ Neni 39(4) dhe (5); rregulla 87(1). *Shih gjithashtu pjesa III(B)(ii) më poshtë.*

¹⁹ *Shih rregulla 85, me titull, 'Funkcionet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake para konfirmimit të aktakuzës', paragrafi (4).*

²⁰ Rregulla 86(2).

²¹ *Shih Vendim në lidhje me kundërshtimet e Mbrojtjes, KSC-BC-2020-07/F00057, 27 tetor 2020, paragrafët 29-31.*

²² ZPS-ja kupton se Urdhri i referohet vetëm mundësisë së nxjerrjes së Aktakuzës, që paraqitet KSC-BC-2020-07/F00063/A01, për Mbrojtjen, por jo të parashtrimet shoqërues të Aktakuzës (KSC-BC-2020-07/F00063) ose të shtojcës 2 (KSC-BC-2020-07/F00063/A02) të këtij parashtrimi. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se duhet t'i nxjerrë këto dokumente të veçanta për Mbrojtjen, ZPS-ja rezervon të drejtën që të bëjë parashtrime të tjera në lidhje me aspekte të tilla.

për të cilën Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se është në përputhje me të drejtat themelore të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.²³ Në këto rrethana, shmangia nga korniza e qartë ligjore krijon pasiguri dhe precedent potencialisht të rrezikshëm. Sikurse përshkruhet më poshtë, gjithashtu një veprim i tillë do të ishte i panevojshëm²⁴ dhe me gjasë do të rezultonte në kontestime juridike të përsëritura që do të vononin në vend që të shpejtonin procedurat.²⁵

(ii) *Aktakuza nuk është e domosdoshme për rishikimin efektiv të paraburgimit të të dyshuarve*

13. Në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ('GJEDNJ'), në këtë fazë përmbajtja konkrete e Aktakuzës nuk është e domosdoshme, madje as relevante për rishikimin e paraburgimit të të dyshuarit, ose për çfarëdo arsye tjetër.²⁶

14. Në veçanti, bazën e ligjshme për arrestimin e të dyshuarve e përbëjnë vendimi për arrestim dhe fletarrestimet, jo Aktakuza e pakonfirmuar. Të dyshuarve u janë dhënë vendimi dhe fletarrestimet dhe gjatë paraqitjeve të para përkatëse, ata u informuan për konstatimin prej Gjykatësit të Vetëm të: (i) dyshimit të bazuar se kishin

²³ *Shih* Aktvendim në lidhje me referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017 [...], KSC-CC-PR-2017-01/F00004, 26 prill 2017, paragrafët 141-167.

²⁴ *Shih* pjesën III(A)(ii) dhe III(B)(ii) më poshtë.

²⁵ *Shih* pjesën III(B)(ii) më poshtë.

²⁶ Gjatë shqyrtimit të shkeljeve të pretenduara të nenit 5(2) të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut (që përcakton se 'çdokush që është arrestuar informohet menjëherë, në një gjuhë që e kupton, për arsyet e arrestimit dhe të akuzave kundër tij'), GJEDNJ-ja ka deklaruar se, megjithëse çdo personi të arrestuar duhet t'i tregohet me një gjuhë të thjeshtë, pa terma teknike, që të mund ta kuptojë arsyet themelore ligjore dhe faktike për arrestimin e tij, që të jetë në gjendje, nëse e sheh të arsyeshme, t'i drejtohet gjykatës për ta kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit, kur një person është arrestuar nën dyshimin se ka kryer krim, nuk është e domosdoshme që informacioni i nevojshëm duhet të jepet në formë të caktuar ose se duhet të përmbajë listën e plotë të akuzave kundër personit të arrestuar, *Shih* European Commission of Human Rights (Plenary), *X v. Federal Republic of Germany*, No.8098/77, Decision of 13 December 1978 on the admissibility of the application, para. 3 (konstatohet se nuk ka pasur shkelje të garancive themelore procedurale të kërkuarit në procedurën e paraburgimit, ku kërkuari është informuar vetëm përmes fletarrestimit për disa, por jo të gjitha faktet kundër tij sepse kishte arsye të mjaftueshme për të arrestuar kërkuarin, këto arsye i ishin të njohura, dhe 'për rrjedhojë rezultatet shitesë të hetimeve kundër tij ishin të tepërta sa i përket arrestimi dhe paraburgimit të tij'); ECtHR, *Nowak v Ukraine*, No.60846/10, Judgment, 31 March 2011, para.63.

kryer, ose kishin tentuar të kryenin veprat penale të frikësimit, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës; dhe (ii) për ekzistencën e arsyeve të artikulueshme për të besuar se arrestimi i tyre ishte i domosdoshëm.²⁷ Rrjedhimisht, të dyshuarit janë tashmë plotësisht të vetëdijshëm për arsyet e paraburgimit të tyre. Faktikisht, bazuar në të gjithë informacionin që ata tashmë disponojnë, të dyshuarit kanë kundërshtuar paraburgimin dhe Gjykatësi i Vetëm i ka hedhur poshtë këto kundërshtime.²⁸

(iii) *Nxjerrja e Aktakuzës për Mbrojtjen mund të dëmtojë hetimet aktuale të ZPS-së*

15. Nxjerrja e Aktakuzës për Mbrojtjen në këtë fazë të procesit mund të ndikojë negativisht në integritetin e provave, dhe mund të dëmtojë hetimet aktuale të ZPS-së.²⁹

16. Nxjerrja e Aktakuzës për Mbrojtjen do t'u jepte të dyshuarve një përshtypje të qartë dhe të parakohshme për natyrën dhe burimet e provave mbështetëse, duke u dhënë në këtë mënyrë mundësi të gjera për ndikim, shtrembërim ose shkatërrim të provave. Në këtë aspekt, sikurse është konstatuar nga Gjykatësi i Vetëm, ekzistojnë rreziqe konkrete që të dyshuarit mund të pengojnë ecurinë e procesit dhe të kryejnë vepra penale të tjera.³⁰

17. Kompetenca e ZPS-së për kryerjen e hetimeve kundër personave që janë penalisht përgjegjës për vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara³¹ nuk përfundon me paraqitjen e aktakuzës. ZPS-ja ka kompetencë për të vazhduar hetimin e veprimeve të të dyshuarve në pritje të konfirmimit të aktakuzës,

²⁷ KSC-BC-2020-07, Transkript, 29 shtator 2020, faqet 4, 6-9; KSC-BC-2020-07, Transkript, 1 tetor 2020, faqet 6-11.

²⁸ Vendim në lidhje me kërkesën e Haradinajt për lirim, KSC-BC-2020-07/F00058, paragrafët 21, 24, 26; Vendim në lidhje me dorëzantinë për Gucatin, KSC-BC-2020-07/F00059, paragrafët 14, 24.

²⁹ Arsye bindëse për mosnxjerrjen e përkohshme të Aktakuzës dhe dokumenteve të lidhura me të janë paraqitur gjithashtu në parashtrimin e ZPS-së që e shoqëron Aktakuzën, *Shih* Parashtrim shoqëruar i Aktakuzës, KSC-BC-2020-07/F00063, para 5-6.

³⁰ Vendim në lidhje me kërkesën e Haradinajt për lirim, KSC-BC-2020-07/F00058, para 21, 24, 26; Vendim në lidhje me dorëzantinë për Gucatin, KSC-BC-2020-07/F00059, para 14, 24.

³¹ *Shih* neni38(1).

përfshirë edhe mundësinë e ndryshimit të aktakuzës.³² Gjithashtu, në këtë fazë të procesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të kërkojë nga Prokurori i Specializuar ose ta lejojë atë, ndër të tjera, që të paraqesë material shtesë në mbështetje të ndonjë ose të gjitha akuzave³³ dhe, në fund, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të vendosë që ta hedhë poshtë Aktakuzën, pjesërisht ose plotësisht.³⁴ Në përputhje me rregullën 86(9), moskonfirmimi i cilësdo akuzë në Aktakuzë nuk e parandalon Prokurorin e Specializuar që të paraqesë akuzë të ndryshuar ose që ta përfshijë të njëjtën akuzë në Aktakuzë të mbështetur në prova të reja.

18. Rrjedhimisht, nxjerrja e Aktakuzës për Mbrojtjen para konfirmimit të saj mund të dëmtojë hetimet aktuale të ZPS-së, ndër të tjera, duke zbuluar ku është përqendruar hetimi, dhe natyrën e provave mbështetëse në lidhje me të dyshuarit.

B. NËSE AKTAKUZA MEGJITHATË I BËHET E DITUR MBROJTJES, AJO DUHET TË REDAKTOHET DHE NUK DUHET TË LEJOHEN PARASHTRIME NË LIDHJE ME TË

(i) *Duhet të redaktohet i gjithë informacioni përveç listës së veprave penale dhe formave të përgjegjësisë penale*

19. Megjithëse ZPS-ja e kundërshton nxjerrjen e Aktakuzës për Mbrojtjen në këtë fazë të procesit, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithsesi vendos të lejojë nxjerrjen e Aktakuzës për Mbrojtjen, duhet të redaktohet paraqitja e fakteve (paragrafët 4-46); duhet të jepen vetëm pjesët që kanë të bëjnë me të akuzuarit dhe paraqitja e veprave penale.

20. Një redaktim i tillë do të thotë se Mbrojtja do të informohej për veprat penale dhe format e përgjegjësisë penale konkrete të përfshira në Aktakuzë, ndërsa do të ruhej natyra *ex parte* e veprimeve konkrete që kanë rezultuar në këto vepra dhe forma të përgjegjësisë penale të pretenduara nga ZPS-ja. Edhe pse nuk i trajton të gjitha

³² Shih rregulla 90(1)(a).

³³ Rregulla 86(4).

³⁴ Neni 39(2), rregulla 86(5).

shqetësimet,³⁵ kjo qasje mund të zvogëlojë disa rreziqe për integritetin e provave dhe të hetimeve aktuale të identifikuara më lart.

(ii) *Nuk duhet të lejohen parashtrime në lidhje me Aktakuzën*

21. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos që ta lejojë nxjerrjen e Aktakuzës për Mbrojtjen në çfarëdo forme, Mbrojtja nuk duhet të lejohet që të bëjë parashtrime në lidhje me Aktakuzën gjatë rishikimit të saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Nëse Mbrojtja lejohet që të bëjë parashtrime në lidhje me Aktakuzën para konfirmimit, konfirmimi dhe faza e procedurës paraprake do të shkrihen në një dhe për rrjedhojë, kjo do të ishte e papajtueshme me kornizën ligjore në fuqi dhe në kundërshtim me interesin e drejtësisë.

22. Korniza ligjore është përpiluar në mënyrë të qartë dhe të qëllimshme për të përjashtuar Mbrojtjen nga procedurat që çojnë në konfirmimin ose hedhjen poshtë të aktakuzës.³⁶ Vetëm pasi të jetë konfirmuar aktakuza dhe i dyshuari bëhet i akuzuar,³⁷ Mbrojtja ndër të tjera mund ta kundërshtojë juridiksionin e Dhomave të Specializuara, të pretendojë mangësi në formën e aktakuzës dhe të kërkojë veçimin e akuzave.³⁸

23. Lejimi i Mbrojtjes që të bëjë parashtrime në lidhje me Aktakuzën para konfirmimit, do të ishte jo vetëm i parakohshëm, meqenëse në këtë fazë Aktakuza mund të ndryshojë ose të hidhet poshtë,³⁹ por edhe në kundërshtim me kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procedurave.

24. Për shembull, së pari, është në interes të kryerjes së drejtë dhe të shpejtë të procedurave që procesi i konfirmimit të jetë sa më i shpejtë që është e mundshme,

³⁵ *Shih* pjesët III(A)(i) dhe (iii) më lart.

³⁶ Për shembull, korniza ligjore ndryshon nga ajo që rregullon procedurën e konfirmimit në GJPN, ku personi i akuzuar gëzon shprehimisht të drejtën që ndër të tjera ta ketë dokumentin që përmban akuzat për të cilat Prokuroria synon ta dërgojë personin para gjyqit, të jetë i informuar për provat në të cilat Prokuroria synon të mbështetet në seancën e konfirmimit dhe t'i kundërshtojë akuzat me të cilat Prokuroria synon ta nxjerrë personin para gjyqit dhe të paraqesë prova në fazën e konfirmimit, *Shih* neni 61 i Statutit të GJPN-së, dhe rregulla 121 e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të GJPN-së.

³⁷ *Shih* rregullën 2(1) ku 'i akuzuari' përkufizohet si 'person fizik kundër të cilit është konfirmuar një apo më shumë akuzë në përputhje me nenin 39(2) të Ligjit dhe rregullën 86'.

³⁸ *Shih* rregulla 97(1).

³⁹ *Shih* neni 39(2), rregulla 86(4) dhe rregulla 90(1)(a).

veçanërisht nëse të dyshuarit janë në paraburgim. Gjithashtu, disa afate të procedurës paraprake, përfshirë sidomos ato që kanë të bëjnë me nxjerrjen e informacionit, hyjnë në fuqi vetëm pas konfirmimit të Aktakuzës,⁴⁰ duke e përforcuar interesin e të gjitha palëve të përfshira të kenë proces të shpejtë të konfirmimit. Parashtrimet e Mbrojtjes dhe kontestimet juridike në këtë fazë – të cilat nuk do të mund të kufizoheshin në asnjë mënyrë të arsyeshme – vetëm do ta ngadalësonin procesin e konfirmimit.

25. Së dyti, nuk është e qartë se si parashtrimet e Mbrojtjes në këtë moment mund shpejtojnë në ndonjë mënyrë fazën e procedurës paraprake.⁴¹ Faktikisht, ato do të rezultojnë vetëm në dyfishimin e mocioneve që Mbrojtja do të kishte të drejtë t'i paraqiste pas konfirmimit, duke krijuar kështu thjesht një dyfishim të kontestimeve juridike dhe do të krijojnë paqartësi sa i përket procedurave, përfshirë dhe të drejtën për apelim.

26. Në formë të përmbledhur, drejtësia dhe shpejtësia e kryerjes së procedurave kërcënohen nëse palët lejohen që të angazhohen në kontestime juridike të panevojshme dhe të përsëritura, që nuk parashikohen prej kornizës ligjore në fuqi.

27. Kjo nuk i paragjykon të drejtat e të dyshuarve duke qenë se: (i) ata janë në gjendje të kundërshtojnë ligjshmërinë dhe arsyet e paraburgimit të tyre dhe të kërkojnë lirim në bazë të informacionit që disponojnë; dhe (ii) nëse konfirmohet Aktakuza, Mbrojtja do të ketë të drejtë, ndër të tjerra, për nxjerrjen e informacionit dhe paraqitjen e mocioneve paraprake, sikurse parashihet prej Ligjit dhe Rregullores.

IV. KLASIFIKIMI

28. Në përputhje me rregullën 82(4), këto parashtrime klasifikohen si 'konfidenciale'. Duke marrë parasysh parashtrimet publike të mëhershme në lidhje

⁴⁰ *Shih, p.sh.*, neni 39(5), rregulla 87(1) dhe (6), rregulla 92(1) dhe (2), dhe rregulla 95. *Shih gjithashtu rregullat 102-103.*

⁴¹ Faktikisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë të qartë se parashtrimet e Mbrojtjes "nuk do të cenonin" të drejtat e të dyshuarve sipas Ligjit dhe Rregullores, Urdhër, para. 11.

me paraqitjen e Aktakuzës,⁴² ZPS-ja nuk e kundërshton ndryshimin e klasifikimit të Urdhrit ose të këtyre parashtrimeve si publike.⁴³

V. MASA QË KËRKOHET

29. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhet të lejojë nxjerrjen e Aktakuzës për Mbrojtjen. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithsesi vendos ta bëjë këtë, Aktakuza duhet të redaktohet siç është përshkruar më lart dhe Mbrojtja nuk duhet të lejohet të bëjë parashtrime në lidhje me Aktakuzën gjatë rishikimit të saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

Numri i fjalëve: 3,161 /në origjinal/

/nënshkrimi/

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

E martë, 17 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë.

⁴² Paraqitja e parë e Hysni GUCATIT, Transkript, 29 shtator 2020, f. 15; Paraqitja e parë e Nasim HARADINAJT, Transkript, 1 tetor 2020, faqet 12-13.

⁴³ Sidoqoftë, ZPS-ja vë në dukje se parashtrimi KSC-BC-2020-07/F00067, paraqitur nga Mbrojtja për z. Haradinaj, është klasifikuar si publik gabimisht dhe para kohe, në kundërshtim me kushtet e rregullës 82(4).